



Republika e Kosovës

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Sumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti shërbimeve këshillimore teknike
Department of Technical and Advisory Services
Departmend za tehničke i savjetodavne usluge



Shërbimi Këshillimor Bujqësor Rural i Kosovës
Kosovo Agriculture and Rural Development Advisory Services
Poljoprivredna Ruralna Savetodavna Služba Kosova

KULTIVIMI I LAKRËS KOKË NË FUSHË TË HAPUR



Te nderuar fermer,

Lakra si për nga sipërfaqet ashtu edhe për nga rëndësia ekonomike, është njëra ndër bimët kryesore perimore në Kosovë. Kultivohet në periudha të ndryshme kohore, duke filluar nga pranvera e hershme deri në vjeshtën e vonshme.



Kërkesat ndaj tokës

Lakra kërkon toka mesatarisht të rënda me regjim të përshtatëm ujor – ajror, të furnizuara mirë e materie ushqyese, me pH 6 deri 7, paraqesin tokat më të përshtatshme për kultivimin e lakrës.

Kërkesat për lagështi janë mjaft të theksuara. KFU, i tokës gjatë kultivimit të lakrës kokë duhet të jetë 70-80%. Gjithashtu, edhe kërkesat ndaj lagështisë së ajrit janë mjaft të theksuara. Gjatë gjithë vegetacionit ajo duhet mbajtur në kufijtë 70-85%.

Lakra kokë dallohet me **kërkesa të vogla ndaj temperaturës**. Fara fillon të mbijë në temperature 4°C, ndërsa temperatura optimale për mbirje është 18 – 20 °C. Deri në fazën e formimit të kokave temperatura preferohet që të jetë 15-20°C, ndërsa në fazën e formimit të kokave 18-20°C.

Ndërrimi i fidanëve në fushë të hapur

Është shumë me rëndësi që fidanët të ndërrohen së bashku me dheun (jo me rrënjë të zhveshura).

Masat e përkujdesit gjatë vegjetacionit

Zakonisht pas 1 – 2 dite, varësisht nga lagështia në tokë fillon regjenerimi i sistemit rrënjor. Gjatë kësaj kohe (dy-tri dit pas ndërrimit), duhet kontrolluar sipërfaqen dhe të bëhet plotësimi i vendeve në të cilat nuk janë zënë fidanët.

Kërkesat e lakrës për lagështi janë të mëdha dhe atë në të gjitha fazat e rritjes së bimëve. Megjithatë momentet më kritike janë:, posaçërisht në fazën: pas ndërrimit të fidaneve, formimi i kokave dhe rritja e kokave.

Dozat dhe numri i ujitjeve caktohen për çdo rast të veçantë, në bazë të kushteve klimatike, tipit të tokës dhe gjendjes së bimëve. Orjentimisht norma optimale e ujitjes është rreth 40 l/m².

Tek lakra kokë përveç që është e rëndësishme që plehrat të jenë në sasi të mjaftueshme ato duhet të jenë mirë të balancuara. Në rastet kur raporti në mes materieve ushqyese nuk është i mirë mund të formohen koka të shkrifëta dhe kompaktësi jo të mirë, që mund të ndikoj mjaft në vlerën tregtare të lakrës kokë.

Me rendiment prej 100 kg lakra kokë nga toka tërheq , 0,35 kg N, 0,15 kg P₂O₅, 0,50 (që përafërsisht është raport 2 : 1 : 3). K₂O dhe 0,07 kg MgO.

Sasitë orientuese të plehrave minerale , në formë të materieve aktive, varësisht nga koha e kultivimit dhe rendimentit të planifikuar: 130 – 310 N, 45 – 100 P₂O₅, 160 – 400 Kg K₂O, 75 – 165 CaO dhe 25 – 55 MgO kg/ha.



Kush mund ofroj informata shtese për nevojat tuaja?

Për këshilla dhe informata tjera te detajuara ju njoftojmë qe mund te drejtoheni ne Qendrat Informative Komunale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, secili ne komunën e vet tek këshilltarët komunal qe janë pjesë e **Departamenti për shërbime këshilluese**. Aty do te merrni edhe sugjerime ne bazë te kushteve klimatike tokësore qe keni ne parcelat tuaja. Te dhënat në mesazh janë orientuese.

Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike, MBPZHR

Rr. "Ukshin Hoti", ndërtesa e ish Ramiz Sadikut, nr 120 Kati III, Prishtinë – Kosova

Tel. 383- (0)3820038426